

Dislocation in French and its Translation into Albanian: The Case of Direct Object



Linguistics

Keywords dislocation, nominative syntagm, direct object, translation.

Fjoralba Dado

University of Tirana, Faculty of Foreign Languages,
Department of French Language. Tirana, Albania.

Abstract

The phenomenon of clitic left dislocation is relatively frequent in French and is traditionally related with spoken language. However, this phenomenon is also observed in the written language, which often imitates the spoken one. After the presentation of a theoretical framework, which describes the way that French and Albanian language consider specifically the clitic left dislocation, we propose a pragmatic approach while analyzing some examples from a corpus of literary works translated from French into Albanian and trying to draw some regular pattern regarding "the left dislocation of direct object", a typical phenomenon of the French language.

Dislokimi në gjuhën frënge dhe përkthimi i kësaj dukurie në gjuhën shqipe: Rasti i kundrinorit të drejtë

Abstrakt

Dukuria e dislokimit apo zhvendosja në të majtë të fjalisë e njërit prej përbërësve të saj dhe rimarrja me trajtë të shkurtër ose përemër klitik shfaqet relativisht shpesh në gjuhën frënge dhe lidhet tradicionalisht me gjuhën e folur. Megjithatë kjo dukuri vihet re edhe në gjuhën e shkruar, e cila shpesh imiton gjuhën e folur. Pas një vështrimi teorik në lidhje me mënyrën se si e trajton gjuha frënge dhe më pas ajo shqipe veçanërisht dislokimin e kundrinorit të drejtë, nisur nga një qasje pragmatike do të analizojmë shembuj të vjelë nga disa vepra letrare të përkthyer nga gjuha frënge në atë shqipe dhe do të përiqemi të nxjerrim disa rregullsi në lidhje me « përkthimin » në gjuhën shqipe « të dislokimit të kundrinorit të drejtë », dukuri tipike e gjuhës frënge.

Fjalë kyçe: dislokim, sintagmë emërore, kundrinor i drejtë, përkthim.

1. Dislokimi në gjuhën frënge

Në gjuhën frënge, dislokimi është një veçori e cila edhe pse lidhet tradicionalisht me gjuhën e folur, vihet re jo pak edhe në gjuhën e shkruar. Sipas studiueses Françoise Gadet, gjuha e shkruar dhe ajo e folur janë dy shfaje të të njëjtit sistem (Gadet: 1982). Megjithatë përfaqësuesit e gramatikës normative për një kohë të gjatë i kanë konsideruar format e gjuhës së folur si jo të sakta, prandaj edhe studimi i dukurisë së dislokimit filloi relativisht vonë. Gjuhëtarët kanë përdorur terma të ndryshëm për të emërtuar dukurinë e dislokimit: dislokim, veçim, segmentim, ekstrapozicion. Gjuhëtari Charles Bally, e përmend termin *dislokim* në veprën e tij *Traité de stylistique française*, në vitin 1909 (Bally, 1951). Dislokimi ngjalli një kuriozitet të madh te gjuhëtarët në vitet 70, të cilët e konsideruan si një mjet modern për ndryshimin e rendit të fjalëve, i cili karakterizonte gjuhën e folur.

Kur flasim për dukurinë e zhvendosjes në të majtë të gjymtyrëve duket se kemi të bëjmë me një funksion sintaksor pjesërisht të krahasueshëm me atë të kryefjalës apo kundrinorit, të cilin gramatikat tradicionale nuk e kanë trajtuar qartë. Me sa duket sikurse thamë më lart, këto gramatika e shohin veçimin si një

veçori të gjuhës së folur. Sipas tyre, fjalitë e mëposhtme nga pikëpamja semantike kanë të njëjtin kuptim ose më saktësisht tregojnë të njëjtën gjë sikurse dhe fjalitë jo të veçuara:

- (1) *Le cœur de cet homme, Feliciano s'en moquait (Porporino, fq. 280)*
Sa për zemrën e atij burri, Feliciano nuk donte t'ia dinte fare (Porporino, fq.213)
- (2) *L'humanité, non, je n'y avais pas renoncé. (La possibilité d'une île, fq.217)*
Jo, unë s'kisha hequr dorë nga mirësia (Ishulli i mundshëm, fq.147)
- (3) *Précoce, je l'avais été, mais trop peu encore, hélas, pour échapper à mon sort. (Porporino, fq.66)*
I pjekur para kohe unë kisha qenë, por prapëseprapë tepër pak, hajmedet, për t'i shpëtuar fatit tim. (Porporino, fq.51-52)

*Feliciano se moquait du cœur de cet homme
je n' avais pas renoncé à l'humanité
J'avais été précocé, etj*

Meqenëse, tradicionalisht funksionet sintaksore janë konceptuar mbi baza semantike, vihet re prirja për t'u njohur këtyre elementeve të njëjtat funksione sintaksore si në fjalitë e paveçuara. Dhe rëndom themi se, kemi të bëjmë me një kundrinor të drejtë apo kryefjalë të veçuar, sikurse thotë shprehimisht *Grammaire française* (Dubois *et al.*, 1961) të vënë në krye me qëllim nxjerrjen në pah të tij. Por, në rast se marrim parasysh veçoritë kombinuere të SE dhe në rast se nuk i përcaktojmë funksionet sintaksore mbi baza semantike është e dukshme se fjalia me element të veçuar majtas nuk i përket të njëjtit rrjet transformimesh apo zëvendësimesh dhe si rrjedhojë, as nuk paraqet të njëjtën strukturë me elementë kryesore sikurse fjalia jo e segmentuar.

Në gjuhën frënge, gramatika tradicionale, funksionin e kundrinorit të drejtë, kryefjalës apo kundrinorit të zhdrejtë ia vesh përemrave klitikë *le, il* ose *lui*. Marrëdhënia semantike e anafors midis SE në krye të fjalisë dhe këtij përemri klitik krijon përshtypjen se, SE e veçuar luan të njëjtin rol semantik me një kundrinor të drejtë, një kryefjalë apo një kundrinor të zhdrejtë. Është me vend të theksohet se vërtetë për trajtimin e punimit kemi ndërmarrë një qasje e tematike por aty-këtu do ta huazojmë terminologjinë e gramatikës tradicionale thjesht për qëllime të analizës krahasuese me gjuhën shqipe në të cilën nuk flitet për dislokim gjymtyrësh në terma të përgjithshëm duke anashkaluar kësaj funksionin sintaksor që këta elemente do të luanin në fjalinë e pashenjuar por për paravendosje apo veçim të tyre sidomos në rastin e kundrinorit të drejtë.

2. Dislokimi dhe gjuha shqipe: rasti i kundrinorit

Të saktësojmë fillimisht, emërtimin e kësaj dukurie (tipike për gjuhën frënge) në gjuhën shqipe. Sikurse u tha më lart, gjuha shqipe flet kryesisht për paravendosje të kundrinorit dhe për veçim të tij. E kemi përjashtuar kundrinorin e zhdrejtë nga ky trajtim pasi në gjuhën shqipe rimarrja e tij me trajtë të shkurtër është e detyrueshme. Gjuhëtari francez Hagège thotë se, për disa gjuhë si greqishtja, shqipja, rumanishtja, shumë më rregullisht se në frëngjisht, vihet re përdorimi i një treguesi vetor (trajtë e shkurtër) të kundrinorit (Hagège, 1992). Ndërkohë që kundrinori i drejtë mund të dalë në pozicion të veçuar por, kjo varet nga grupi që shpreh kryefjalën. Në fakt, në gjuhën frënge kundrinori i drejtë mund të veçohet dhe të rimerret me një element në fjalinë që pason. Një fjali pa elementin anaforik do ta humbiste karakterin e saj gramatikor. Ndërkohë, në gjuhën shqipe kundrinori i drejtë, i cili ndoshta veçohet dhe paravendoset më pak, me sa duket për shkak të kushtëzimit të vendit të tij pranë predikatit, në rast se nuk rimerret me trajtë të shkurtër (fr. *përemër klitik*) përbën remën e thënies. Por, kur dhe si paravendoset apo veçohet ky kundrinor në gjuhën shqipe?

2.1 Disa vërejtje teorike mbi kundrinorin

Thoma Rrushi në shkrimin e tij *Rreth rendit të gjymtyrëve në fjalinë dëftore* shprehet se funksioni themelor i rendit të gjymtyrëve për gjuhën shqipe është funksioni kumtues (Rrushi, 1983). Ai bën një analizë të hollësishme të mënyrës si paraqitet dhe nga se kushtëzohet rendi i gjymtyrëve në fjalinë e thjeshtë dëftore me kryefjalë, kallëzues dhe kundrinor të drejtë. Për përcaktimin e përbërësve të gjymtyrëzimit aktual edhe ai propozon ndër të tjera praninë ose mungesën e trajtës së shkurtër që rimerr kundrinori. Në fakt, Th. Rrushi flet për tematizim dhe rematizim të kundrinorit të drejtë të kushtëzuar nga prania ose mosprania e trajtës së shkurtër. Si kriter praktik për identifikimin e remës dhe të temës edhe ai përdor metodën e pyetjeve, e cila është përdorur më parë dhe nga gjuhëtarë të huaj. Sipas këtij kriteri, gjymtyrët e fjalisë që përfshihen në pyetje janë temë, gjymtyrët që dalin si përgjigje janë remë e thënies. Ndër shembujt që autori ka marrë në shqyrtim nuk dallohet asnjë rast i veçimit me presje të kundrinorit të drejtë nga pjesa tjetër e fjalisë.

Ndërkohë *Gramatika e Gjuhës Shqipe II*, në kapitullin kushtuar gjymtyrëve të veçuara flet dhe për veçimin e kundrinorit, madje duke mos bërë dallim midis kundrinorëve:

“Mund të veçohet edhe kundrina, veçanërisht disa nëntipa të kundrinës së zhdrejtë me paraafjalë e disa ndërtime analoge. Për arsye stilistike, për ta vënë më në pah, për të theksuar mund të veçohet në letërsinë artistike edhe një kundrinë e drejtë ose një kundrinë e zhdrejtë pa ose me paraafjalë. Veçimi ndodh zakonisht, kur kundrina është në krye të fjalisë. Ajo ndahet me pauzë dhe në të shkruar me presje. Zgjerimi me fjalë plotësuese mund të ndihmojë veçimin po faktor kryesor është synimi theksues”(Akademia e Shkencave, 1996).

Në vazhdim, gramatika flet dhe për elementët e ndryshëm në rolin e kundrinorit që mund të veçohen por, ne do ta përqendrojmë vëmendjen tonë kryesisht të veçimi majtas i kundrinorit të drejtë. Në fakt, ky përkufizim i veçimit majtas të kundrinorit i përgjigjet deri diku objektit të trajtimit tonë, sidomos kur flet për veçimin e kundrinës me presje në të shkruar. Arsyet e tjera të veçimit janë përmendur dhe nga Th. Rrushi.

Edhe Dalina Kallulli, flet për rolin e dublimit të kundrinorit në gjuhën shqipe por, këtë radhë nga një qasje gjenerativiste (Kallulli, 2000). Ajo e sheh përdorimin e trajtave të shkurtra si një fenomen të hasur në disa gjuhë ballkanike dhe më konkretisht në gjuhën greke. Kallulli futet në brendësi të dublimit të kundrinorit të drejtë për të parë natyrën e kësaj dukurie dhe përpiket t’i përgjigjet pyetjes se, pse lind nevoja për të dubluar kundrinorin e drejtë. Njehsimi i faktorëve që përcaktojnë përdorimin e trajtës së shkurtër të kundrinorit të drejtë bëhet i mundur në sajë të një analize sintaksore. Duke iu referuar Kallulli (2000), në gjuhën shqipe dublimi i kundrinorit të drejtë me një përemër klitik ndodh si me sintagma emërore (SE) të shquara ashtu dhe me sintagma emërore të pashquara.

Shaban Demiraj, në studimin e tij kushtuar rimarrjes së kundrinave, flet për faktorët që e kushtëzojnë një dukuri të tillë (Demiraj, 1986). Rimarrja e kundrinave është e kushtëzuar nga përdorimi si *remë* apo si *temë* e kumtimit. Sipas tij, përpjekjet për ta shpjeguar rimarrjen, përkatësisht anticipimin e kundrinorëve të shprehur me anë emrash ose togfjalëshash emërorë nëpërmjet teorisë së gjymtyrimit aktual të fjalisë shënojnë një hap përpara në sqarimin e dukurisë në shqyrtim. Po kështu, Demiraj e sheh rimarrjen, apo siç e quan ai anticipimin e kundrinave nëpërmjet formave të patheksuara të përemrave vetorë në gjuhët ballkanike, si një përdorim ridondant të mjeteve leksiko-gramatikore për qëllime të caktuara *kumtimore*.

Gjithsesi, secili nga këto punime, kush më shumë e kush më pak, do të na ndihmojë në trajtimin e mëtejshëm të çështjes së dislokimit të kundrinorit të drejtë në gjuhën shqipe sipas një qasjeje kryesisht pragmatike.

3. Mënyrat e “përkthimit të dislokimit” në gjuhën shqipe

Gjatë klasifikimit dhe analizës së shembujve tanë, ne kemi hasur jo pak shembuj që paraqesin dukurinë e dislokimit. Në fakt, nuk rrekemi të paraqesim një listë shteruese të të gjitha mënyrave të mundshme të “përkthimit të dislokimit” por, vetëm disa prej tyre pasi me siguri që ka dhe të tjera. Qëllimi ynë është që të tregojmë se dukurisë së dislokimit të gjuhës frënge në gjuhën shqipe i përgjigjet një dislokim alla francezçe, një paravendosje e kundrinorit si dhe një prapavendosje e tij. Le të shohim sesi konkurrojnë mes tyre këto tre mundësi dhe cila do të ishte më e përshtatshme për t’u përdorur.

3.1 Skema 1: Strukturë të njëjtë: Dislokim FR=AL

$$X^T / (S+oP)^R = X^T / (S+oP)^R^{47}$$

Po të shohim shembujt e mëposhtëm dhe përkthimin e tyre në gjuhën shqipe do të vëmë re se dislokimit të gjymtyrës X, e cila rimerret me anë të një përemri klitik, në gjuhën shqipe i përgjigjet i njëjti ndërtim, i cili ka jo vetëm të njëjtin kuptim por edhe të njëjtën ndarje aktuale si varianti origjinal. Për më tepër dhe paraqitja grafike është e njëjtë (veçimi me presje i gjymtyrës “X” në të dyja gjuhët). Sipas mendimit tonë, kjo do të ishte dhe mënyra më e saktë për ta përkthyer por, sikurse do të vëmë re dhe më pas jo gjithmonë mund të respektohet një skemë e tillë. Në këta shembuj vihet re dislokimi i kundrinorit të drejtë të shprehur me një SE të shquar (4) dhe me një fjali kundrinore pyetëse të zhdrejtë (6) si dhe i kundrinorit të zhdrejtë (3) të shprehur me SE të shquar. Tashmë, është i njohur fakti sipas të cilit elementi i dislokuar karakterizohet nga një shkallë e lartë shquarsie duke qenë se paraqet temën e thënies. Përkthimi i shembullit (6) paraqet një elips të kryefjalës në fjalinë drejtuese. Kjo shpjegohet me faktin se kryefjala e shprehur me përemër në gjuhën shqipe është e nënkuptuar dhe nuk lipset përdorimi i saj.

- (4) *La peste, nous la portons en nous* (Porporino, fq. 308) (Kundrinor i drejtë)
Murtajën, ne e kemi brenda vetes (Porporino, fq. 236)
- (5) *Le coeur de cet homme, Feliciano s'en moquait* (Porporino, fq. 280) (Kundrinor i zhdrejtë)
Sa për zemrën e atij burri, Feliciano nuk donte t'ia dinte fare (Porporino, fq. 213)
- (6) *Comment il était arrivé jusqu'à moi, je l'ai oublié* (L'amant, fq.19)
Sesi erdhi deri tek unë kjo kapele, e kam harruar (Dashnori, fq. 14)

3.2 Skema 2. Dislokim FR => vargëzim me paravendosje

$$X^T / (S+oP)^R => O^T (S+oP)^R$$

Le të analizojmë fjalitë e mëposhtme:

- (7) *Semblable jouissance, je l'ai éprouvée qu'à l'intérieur de l'église San Gregorio Armeno* (Porporino, fq.166)
Një kënaqësi të ngjashme e kam provuar vetëm brenda kishës së Shën Grigor Armenit (Porporino, fq.126)
- (8) *Ce mot, je ne le sépare plus de ma vie* (L'amant, fq. 126)
Këtë fjalë nuk do ta ndaja kurrë tërë jetën time (Dashnori, fq. 91)

⁴⁷ Me “X” do të shënojmë gjymtyrën e dislokuar apo kundrinorin e dislokuar, me / = pauza në të folur ose presje në të shkruar, me “S”- do të shënojmë kryefjalën, me “o” përemrin klitik apo trajtën e shkurtër të kundrinorit të drejtë, me « P » predikatin, me « O » kundrinorin e drejtë, me «^T » temën, me «^R » remën.

Në të dy rastet, kemi të bëjmë me ndërtime të dislokuara të gjuhës frënge të rimarra me përemër klitik. Ndryshimi me skemën e parë qëndron në faktin se në variantin shqip të këtyre fjalive nuk vihet re prania e presjes, e cila veçon në gjuhën burimore gjymtyrën X nga pjesa tjetër e fjalisë. Një rast i tillë në gjuhën shqipe shihet si paravendosje e kundrinorit të drejtë dhe si tematizim i tij. Gjithsesi, duhet thënë se ka një ndryshim, i cili qëndron në rrafshin prozodik pasi në gjuhën frënge gjymtyra e dislokuar ka intonacion në ngritje, i cili fillon e zbret gradualisht drejt fundit të fjalisë. Ndërsa në gjuhën shqipe vetëm prania e presjes do të mund të siguronte të njëjtin interpretim prozodik me ndërtimin e gjuhës burimore. Përveç dallimit prozodik në variantin në shqip në të dyja fjalitë, sërish vëmë re, mungesën e kryefjalës përemërore të nënkuptuar.

3.3 Skema 3: Dislokim FR => Vargëzim me prapavendosje

$$X^{T1}/S^{T2} - oP^R \Rightarrow S^{T1} - (P-O)^R \text{ dhe } S^{T1} - oP^R - O^{T2}$$

Skema e tretë që kemi arritur të pikasim ndër shembujt tanë përmban prapavendosjen e kundrinorit të drejtë dhe rivendosjen “në rregull” të elementeve të fjalisë. Një rikthim i vargëzimit, për mendimin tonë, sjell një bjerrje, tanimë jo në rrafshin semantik, por në atë pragmatik, stilistikor dhe intonacionor. Këtu, mendojmë të marrim në shqyrtim dy raste:

- Në variantin shqip, gjymtyra X e gjuhës frënge e humbet karakterin tematik të saj duke u shndërruar në remë të thënies dhe në këtë rast kemi të bëjmë me një ndryshim në rrafshin pragmatik dhe stilistik.
- Në variantin shqip, gjymtyra X e gjuhës frënge nuk e humbet karakterin tematik të saj, pasi ajo sërish bën pjesë në temën e kumtimit por efekti stilistikor nuk është më i njëjtë.

3.3.1 Rasti A

- (9) *Désormais ils ne doivent plus savoir ce qu'il adviendra d'elle. Qu'on la leur prenne, qu'on la leur emporte, qu'on la leur blesse, [..], ils ne doivent plus le savoir (L'amant, fq. 46)⁴⁸*

Tashmë ata nuk duhet të dinin ç'do të ndodhte me të. Ata nuk duhet të dinin se po ua merrnin, se po ua hiqnin nga duart, se po ua plagosnin (Dashnori, fq. 33)

(Fr.) $X^{T1}/S^{T2} - oP^R \Rightarrow (Al.) S^{T1} - (P-O)^R$ - Në fakt, në tekstin e sipërpërmendur, kemi të bëjmë me dy periudha, të cilat përbëhen secila nga një fjali kryesore dhe një fjali e varur kundrinore. Pozicioni i këtyre fjalive në secilën periudhë nuk është i njëjtë. Në periudhën e parë, fjalia kryesore është vendosur në krye dhe pas saj vjen fjalia kundrinore e shprehur me një fjali pyetëse të zhdrejtë të cilën në skemë e kemi shënuar me O (kundrinor i drejtë). Ndërkohë në periudhën e dytë, tek e cila do të përqendrohet më së shumti vëmendja jonë, fjalia kundrinore, e cila sikurse kuptohet nga vetë emërtimi i saj kryen funksionin e kundrinorit të drejtë, në variantin origjinal, ndodhet e shkëputur dhe e rimarrë me një përemër klitik (trajtë të shkurtër) në fjalinë kryesore. Vendosja në krye të periudhës dhe veçimi me presje nga fjalia kryesore, bën që vërtetësia e fjalisë së varur të mbetet pezull (Riegel et al., 1997). Një gjë e tillë shpjegon dhe përdorimin e mënyrës lidhore në gjuhën frënge. Në variantin shqip, nuk kemi më rimarrje të kundrinorit me trajtë të shkurtër dhe rrjedhimisht kjo gjymtyrë e ndërron statusin kumtues të saj, duke kaluar nga temë e thënies në remë të saj (Demiraj, 1986, Kallulli, 2001, Rrushi, 1983). Megjithatë ia vlen të përmendim se gjuha shqipe e pranon një paravendosje të fjalisë së varur kundrinore për arsye të gjymtyrëzimit aktual si dhe për arsye stilistikore. Në gjuhën shqipe mund të paravendoset vetëm fjalia kundrinore me lidhëzën *që* dhe jo *se* (Akademia e Shkencave, 1986):

Që po ua marrin, që po ua heqin nga duart, që po ua plagosin, këtë ata nuk duhet ta dinë (përkthim i yni).

⁴⁸ Shënim: Në disa raste, fjalitë do të shoqërohen me kontekstin paraprakisht apo pasues për të sqaruar më saktësisht lidhjet referuese që ngërthen elementi apo ndërtimi i dislokuar me kontekstin në të majtë apo në të djathtë.

Mendojmë se gjuha jonë është mjaftueshëm e pasur për të shprehur këtë dukuri të veçimit majtas sikurse dhe gjuha frënge. Vetëm atëherë kur gjuha shqipe nuk e ofron këtë mundësi mund t'i drejtohem linearizimit apo ndonjë mënyre tjetër.

3.3.2 Rasti B

(Fr.) $X^T, (S+oP)^R \Rightarrow (Al) S^{T1} - (P-O)^R$ - Fjalja në gjuhën frënge (e rrethuar) i përgjigjet skemës $X^T, (S+oP)^R$ ndërsa fjalja në gjuhën shqipe skemës $S^{T1} - (P-O)^R$. Përveç kallëzuesit, duket se gjymtyrët e tjera e kanë ndryshuar statusin kumtues të tyre.

(10) [Je m'apprêtais à lui (= Luisilla) demander si elle commençait à ressentir les bienfaits de notre serment et à se relever de ce tort mystérieux qu'elle avait eu à subir, quand soudain, net, inexorable et familier, j'entendis de l'autre côté de la place le cri d'appel de ma mère. J'imaginai si bien ce qui vaît pu se passer en mon absence !(...) M a mère toutefois s'en était vite aperçue.... Mes frères et mes sœurs s'étaient mis à courir autour de la table.(...) Devant le vacarme qui s'était déchaîné dans la pièce, et constatant l'absolue indifférence de mon père au remue-ménage de ses enfants, elle n'arrivait plus à réprimer son irritation. (..) Mon père une fois lâché sur son sujet favori, ne s'arrêtait plus.(...) Puis sans remarquer que ma mère, épouvantée de l'entendre récriminer à tort et à travers contre le ciel, se signait à toute vitesse au-dessus du fourneau, il proclamait que je n'étais bon à rien. (...) Ma mère se tordait les mains et s'arrachait les cheveux. (...) elle cherchait en vain le moyen de me protéger contre les prophéties qui sortaient de plus en plus menaçantes de la bouche de mon père. Et comme il redoublait de violence, peut-être pour se faire pardonner la décision que dans le secret de son cœur il avait déjà prise à mon sujet, elle se sentait si oppressée par la rigueur du verdict prononcé contre moi, qu'elle n'avait plus qu'un recours, partir à ma recherche et pousser ce long ululement dans la nuit. (..)

Tous les épisodes pénibles survenus entre mes parents dans les dernières semaines, ce cri me les remit en mémoire (Porporino, fq.115)

Po bëhesha gati ta pyesja në kishte filluar t'i ndiente të mirat e betimit tonë dhe ta merrte veten nga ajo e keqe e mistershme që i ishte dashur të hiqte në kurriz, kur papritmas, nga ana tjetër e sheshit, më erdhi në vesh, e prerë, e pamëshirshme dhe e njohur, britma e nënës sime që po më thërriste. E përfytyroja aq mirë se çfarë mund të kishte ndodhur në shtëpi gjatë mungesës sime! (..) Ime më e kishte pikasur shpejt ... Vëllezërit dhe motrat e mia kishin nisur të vraponin rreth tryezës..... Para poteres që kishte shpërthyer në odë dhe duke vënë re moskokëçarjen e plotë të tim eti për rëmujen e fëmijëve të tij, ajo nuk e përmbante më dot inatin. (...) Mirëpo im atë, sapo t'i dilte në shteg tema më e dashur, nuk ndalej më. (...) Pastaj, pa e vënë re se ime më, e lebetitur tek e dëgjonte të ngrinte zërin ashtu kuturu kundër qiellit, bënte kryq shpejt e shpejt përmbi shporet, ai shpallte botërisht se unë nuk isha për gjë prej gjëje. (..) Ime më ndrydhte duart dhe i shkulte vetes flokët. (...)ajo kërkonte më kot si e si të më mbronte nga ato profeci që dilnin gjithnjë e më kërcënuese nga goja e tim eti. Dhe ngaqë ai bëhej dyfish më i rrëmbyer, mbase për të kërkuar ndjesë për vendimin që kishte marrë tashmë për mua fshehurazi në thellësi të zemrës, ajo ndihej aq e dërrmuar nga rreptësia e dënimit të shpallur kundër meje, saqë i mbetej vetëm një mjet lëshimi, të dilte për të më kërkuar dhe të lëshonte atë ulërimë të gjatë nëpër natë. (..).

Ajo klithmë m'i solli në kujtesë të gjitha episodet e dhimbshme që kishin ndodhur mes prindërve të mi javëve të fundit (Porporino, fq. 89)

Jo pa qëllim fjalinë që do të analizojmë e kemi shkëputur nga teksti së bashku me kontekstin që e rrethon. Në këtë tekst të shkëputur bëhet fjalë për protagonistin e romanit i cili tek qëndronte me miken e tij Luizilën dëgjon britmën e nënës që po e thërriste. Kjo britmë e pamëshirshme ishte tashmë e njohur për të dhe në tekst renditen të gjitha episodet që britma i kujton. Në fjalinë e parë sintagma le cri d'appel de ma mère është pjesë e remës së fjalisë. Pjesa që vijon, e cila fillon me një temë të re dhe si remë dalin të gjitha episodet që

ndërmend protagonisti, në fundin e saj e rimerr sërish këtë element rematik por që këtë herë është kthyer në element tematik, tashmë të njohur për lexuesin. Në fjalinë e fundit të tekstit në gjuhën frënge, rema e pjesës ligjërimore pararendëse përbën temën e kësaj fjalie (Dibra et al., 1999). Pra, gjymtyra X e dislokuar dhe e rimarrë me përemër klitik, *Tous les épisodes pénibles survenus entre mes parents dans les dernières semaines*, është pjesë e temës së kësaj fjalie. Në rast se do të përdornim metodën e pyetjes, pyetja do të binte mbi elementin e topikalizuar, i cili përbën temën e fjalisë dhe pjesa tjetër remën e saj. Brenda kësaj reme mund të vazhdojmë me një tjetër ndarje ku *ce cri* do të ishte temë dhe pjesa tjetër, remë :

(11) *Tous les épisodes pénibles survenus entre mes parents dans les dernières semaines ? Ce cri me les remit en mémoire.*

Nga përkthimi i këtij pasazhi në gjuhën shqipe, vëmë re se dukuria e shkëputjes majtas që ekziston në tekstin në gjuhën frënge është zëvendësuar me një strukturë lineare, e cila për hir të së vërtetës, dhe gjithnjë sipas mendimit tonë, nuk ngjall të njëjtin efekt emfatik të lexuesi. Rikthimi të rendi i drejtë S-V-O bën që fjalitë të humbasë peshën e saj të ngarkuar me efekte stilistikore të veçanta. Sintagma *Tous les épisodes pénibles survenus entre mes parents dans les dernières semaines* shërben për të përmbledhur të gjitha episodet që autori i përmend në kontekstin e afërt. Në këtë mënyrë, paravendosja e kësaj sintagme, e cila ka për funksion të rikujtojë një fakt apo fakte tashmë të përmendura, sikurse janë zënkata që ndodhnin herë pas here mes prindërve, shërben si urë lidhëse me tekstin paraprijës. Ndërkohë në variantin në gjuhën shqipe këtë funksion lidhës tashmë e kryen sintagma *ajo klithmë*, e cila luan rolin e kryefjalës dhe të temës.

Falë një qasjeje krahasimtare dhe pragmatike, u bë e mundur shquarja e ndryshimeve që paraqesin gjuhët frënge dhe shqipe në lidhje me dukurinë e dislokimit. Gjatë analizës përkthimore vëmë re se përkthyes të ndryshëm kishin përdorur herë struktura të ndryshme dhe herë të njëjta për të përcjellë në gjuhën shqipe strukturat e dislokuara. Edhe pse në gjuhën shqipe janë të rralla rastet kur mund të flitet për dislokim të SE apo të kundrinorit, sikurse shprehet gramatika tradicionale, paravendosja e tij do të mund të përcillte thujtë të njëjtat vlera dhe të vishte të njëjtat funksione me ato të dislokimit në gjuhën frënge. Për mendimin tonë, rikthimi i strukturës lineare në gjuhën shqipe, të paktën në këtë rast, bën që produkti përfundimtar të humbasë jo pak nga vlerat dhe efektet e tekstit në gjuhën burimore. Jemi të mendimit se, gjuha shqipe falë rendit të gjymtyrëve, funksioni kryesor i të cilit është shprehja e gjymtyrëzimit aktual, zotëron struktura të tjera të paravendosura apo të veçuara, të cilat do të përbënin një barasvlerës të denjë semantik, pragmatik, emfatik, intonacionor të ndërtimit të dislokuar në gjuhën frënge.

Referenca bibliografike

1. Akademia E Shkencave. (1996) Gramatika e gjuhës shqipe II, Tiranë.
2. Bally, C. (1951) *Traité de stylistique française*, Genève-Paris.
3. Demiraj, Sh. (1986) Gramatika historike e gjuhës shqipe, Tiranë.
4. Dubois, J. ; JOUANNON, G. ; LAGANE, R. (1961) *La grammaire française*, Larousse.
5. Hagège, C. (1992) *Le souffle de la langue*, Paris, Éditions Odile Jacob.
6. Kallulli, D. (2000) *Direct object clitic doubling in Albanian and Greek* in F.Beukema & M. den Dikken (eds.) *Clitic Phenomena in European Languages* 209-248. Amsterdam: John Benjamins.
7. Riegel, M. ; Pellat, J. ; Rioul, R. (1997) *Grammaire méthodique du français*, PUF, Paris.
8. Rrushi, Th. (1983) *Rreth rendit të gjymtyrëve në fjalinë dëftore*, Sudime Filologjike, Nr.1, fq.71-85.

Vepra letrare të cituara

1. Duras, M. (1984) *L'amant*, Editions Minuit, Paris.
2. Dashnori (2005) përktheu Nasi Lera Shtëpia botuese Koha Ditore, Prishtinë.
3. Fernandez, D. (2008) *Porporino ou les mystères de Naples*, les Cahiers Rouges Grasset, Paris.

4. Porporino ose misteret e Napolit (2008) përktheu Arben Leskaj, Shtëpia botuese Dudaj.
5. Houellebecq, M. (2005) La Possibilité d'une île, Fayard.
6. La Possibilité d'une île, versioni elektronik (e-book).
7. Ishulli i mundshëm (2010) përktheu Saverina Pasho, Shtëpia botuese Skanderbeg books.